

## **GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË**

**P.nr. 123/08**

**1 Nëntor 2010**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË**, me trupin gjykues të përbërë nga Gjykatësja e EULEX-it Caroline Charpentier si Kryetare e Trupit Gjykues, dhe Gjykatëset e EULEX-it Hajnalka Veronika Karpati dhe Christine Lindemann-Proetel, si anëtare të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore të EULEX-it Noora Aarnio si Procesmbajtëse në çështjen penale kundër;

**Bashkim IGRISHTA**, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorit Prokurori Publik: nr. 109/2008 të datës 17.11.2008 të paraqitur në Shkrimoren e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë më 17 Nëntor 2008 dhe siç është konfirmuar me Aktvendimin mbi Konfirmim të Aktakuzës të datës 18 Maj 2010, Rastet e Rënda të Vjedhjes Grabitqare apo të Grabitjes (Neni 256, paragrafi 1, në lidhje me Nenin 255 paragrafi 1 dhe 2 në lidhje me Nenin 23 të KPK),

Pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik më 1 Nëntor, në praninë e të akuzuarit Bashkim Igrishta, Avokatit të tij Mbrojtës Agim Lushta, Palëve të Dëmtuara Sadik Sadiku dhe Hanife Sadiku, Përfaqësuesit të Autorizuar të Palëve të Dëmtuara Sheremet Ademi dhe Prokurorit Publik të EULEX-it Adebayo Kareem, pas shqyrtimit dhe votimit të trupit gjykues të mbajtur më 1 Nëntor 2010, sipas Nenit 392 paragrafi (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), ka shpallur – në të njëjtën ditë – publikisht dhe në praninë e të akuzuarit, Avokatit të tij Mbrojtës, Palëve të Dëmtuara, Përfaqësuesit të Autorizuar të tyre dhe Prokurorit Publik të EULEX-it, këtë

### **AKTGJYKIM**

**Akuza** për Rastet e Rënda të Vjedhjes Grabitqare apo të Grabitjes nga Neni 256, paragrafi 1, në lidhje me Nenin 255 paragrafi 1 dhe 2 në lidhje me Nenin 23 të KPK kundër të akuzuarit Bashkim Igrishta, nuk ka nofkë, i biri i Isa Igrishtës dhe Fatime Zeqirit, i lindur më 30 Nëntor 1977 në Mitrovicë, Kosovë, i etnisë Shqiptare, banor i Mitrovicës, i vejë, niveli përfundimtar i arsimimit shkolla fillore, i papunë, me gjendje të varfër ekonomike, shumë dënime të njohura të mëparshme, në paraburgim nga 13 Tetori 2008 deri në 18 Tetor 2009, refuzohet sipas nenit 389 pika 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK)

-sepse më 1 Nëntor 2010 në seancën e shqyrtimit gjyqësor prokuroria i ka tërhequr akuzat kundër BASHKIM IGRISHTËS dhe palët e dëmtuara nuk kanë vazhduar me ndjekjen penale subsidiare.

Shpenzimet e procedurës penale do të paguhen nga burimet buxhetore sipas Nenit 103 paragrafi (1) i KPPK.



## Arsyetimi

Në aktakuzën PP.nr. 109/2008 të datës 11 Nëntor 2008 të konfirmuar me Aktvendimin mbi Konfirmimin e Aktakuzës të datës 18 Maj 2010, Bashkim Igrishta është akuzuar për Rastet e Rënda të Vjedhjes Grabitqare apo të Grabitjes (Neni 256, paragrafi 1, në lidhje me Nenin 255 paragrafi 1 dhe 2 në lidhje me Nenin 23 të KPK).

Më 1 Nëntor 2010, dita e parë e shqyrtimit gjyqësor, pas ekzaminimit të njëres prej dy palëve të dëmtuara, të dëgjuar në rolin e dëshmitarit, dukej se dëshmitari kryesor e mohoi tërësisht pjesëmarrjen e të pandehurit në vjedhjen e rëndë dhe vazhdoi me identifikimin e dikujt tjetër. Pas ballafaqimit të dëshmitarit me provat e përfshira në dosje të lëndës, siç është deklarata që ai ia ka dhënë policit në ditën e sulmit, prokuroria i ka tërhequr akuzat kundër Bashkim Igrishtës.

Palët e dëmtuara nuk kanë vazhduar me ndjekjen penale subsidiare.

PRANDAJ, sipas Nenit 389 pika 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) akuzat për Rastet e Rënda të Vjedhjes Grabitqare apo të Grabitjes Neni 256, paragrafi 1, në lidhje me Nenin 255 paragrafi 1 dhe 2 në lidhje me Nenin 23 të KPK kundër të akuzuarit Bashkim Igrishta janë **refuzuar**.

Pasi që akuzat kundër Bashkim Igrishtës janë refuzuar, shpenzimet e procedurës penale do të paguhen nga burimet buxhetore sipas Nenit 103 paragrafi (1) të KPPK.

Gjykata e Qarkut në Mitrovicë  
P.nr. 123/2008

Përgatitur në Anglisht, si gjuhë e autorizuar.

Noora Aarnio  
Procesmbajtëse

Caroline Charpentier  
Kryetare e Trupit Gjykses

1



<sup>1</sup> Faqja e fundit e versionit anglisht përmban nënshkrimet e dy anëtarëve të Trupit Gjykses: Hajnalka Veronika Karpati dhe Chrisne Lindemann-Proetel dhe këshillën juridike: Aktgjykimi u bë i plotfuqishëm më 9 Nëntor 2010 dhe në versionin shqip kjo faqe mungon.